Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 354/01
Datë 01.10.2014

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 1/2011- Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4,7,10 dhe 16, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 01.10.2014 nxjerr këtë:

VENDIM

1. Për akreditimin e Kolegjit "Biznesi", për periudhën 3 vjeçare, 01. 10. 2014 deri 01.10. 2017 për këtë/o kualifikime të aprovuara:

   1.1. Teknik i mbrojtes nga Zjarri, niveli i KKK-së (III).

   Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit me datë: 16.09.2014, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

- Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit;
  Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
  Raporti i Vetë-vlerësimit;
  Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe

Dokumente tjera shtesë.

1.2. Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

3. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

4. Vendimi i dërgohet:

- Kolegjit "Biznesi"; dhe
- AKK.

Kryetari i KD së AKK-së
Ragip Gjoshi